



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 06.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 03.07.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Roza Komani B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc”, Nr. i prokurimit- 632-23-4357-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-053 -521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik Roza Komani B.I. SH.P.K., e dt.03.07.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc”, Nr. i prokurimit- 632-23-4357-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-053 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 26.06.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 26.06.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.03.07.2023, Operatori Ekonomik Roza Komani B.I., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc”, Nr. i prokurimit- 632-23-4357-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-053 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 06.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se Autoriteti kontraktues nuk ju ka dhënë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, nuk qëndron, sepse nuk është e mundur që një Operator Ekonomik të vij në Zyrën e prokurimit dhe mos t'i jepet dokumentacioni i kërkuar.

Sa i përket pretendimit tuaj për planin dinamik, Autoriteti kontraktues sqaron se në dosjen e tenderit ka qenë i caktuar pragu më i lartë ose baras me 365 ditë dhe më i ulët se 395 ditë i cili është vlerësuar me 20 pikë (shih tabelën më poshtë).

Prandaj edhe pse ju keni dhënë planin dinamik 180 ditë, nuk keni mundur të vlerësoheni me më shumë se 20 pikë: dhe keni pasur çmim më të lartë

Aneksi 6. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS²

Kriteri për dhënien e kontratës

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm:

Nr.	Nën-kriteri	Koeficient
1	Çmimi	0.70
2	Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit te kontratës deri maksimum 24 muaj / 720 dite AK kontraktues ka vendosur afetet kohore konform normave dhe standardeve ndërtimore, ku është vlerësuar minimumi dhe maksimumi i afatit për implementim të këtij projekti, duke u bazuar në kapacitetet teknike dhe profesionale që kanë OE: < 395 dhe ≥ 365 ditë = 20 pikë < 420 dhe ≥ 395 ditë = 15 pikë < 480 dhe ≥ 420 ditë = 10 pikë < 720 dhe ≥ 480 ditë = 5 pikë	0.20
3	Afati me i gjate i Periudhës Garantuese deri ne max 3 vite	0.10

Çmimi

Afati i implementimit

Periudha garantuese

Kategoritë		Përshkrimi i kriterëve	Pesha	Metoda e Vlerësimit
1	Çmimi	Pikët <100x 60 %> për tenderin me çmimin më të ulët. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	60%	$P = \frac{P_s}{P_t} \times [100x\%]$
2	Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit te kontratës deri ne maksimum 365 ditë pune. AK kontraktues ka vendosur afetet kohore konform normave dhe standardeve ndërtimore, ku është vlerësuar minimumi dhe maksimumi i afatit për implementim të këtij projekti, duke u bazuar në kapacitetet teknike dhe profesionale që kanë OE. < 395 dhe ≥ 365 ditë = 20 pikë < 420 dhe ≥ 395 ditë = 15 pikë < 480 dhe ≥ 420 ditë = 10 pikë < 720 dhe ≥ 480 ditë = 5 pikë	Pikët <100x 30%> për tenderin me periudhe me te shkurt te implementimit. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	30%	$D = \frac{D_s}{D_t} \times [100x\%]$ *Formula nuk do te vlejë në raste se te kategoria janë specifikuar pikët për secilin afat kohor. Pra pikët llogariten në bazë të afatit të dhënë
3	Afati me i gjate i Periudhës Garantuese deri ne max 3 vite	Pikët <100x 10%> për tenderin me periudhe me te gjate garantuese. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	10%	$G = \frac{G_s}{G_t} \times [100x\%]$
			100 %	

ku P- Pikët për tenderin, Ps= Çmimi më i ulët, Pt = çmimi i tenderit

ku D - Pikët për tenderin, Ds= piket per tenderin per periudhën me te shkurtër te dorezimit, Dt = piket per periudhën e tenderit

ku G - Pikët për tenderin, Gt= piket per tenderin per periudhën me te gjate garantuese, Gs = piket per periudhën e tenderit

Jju lutemi ta plotësoni edhe ANEKSIN 6.1 sa i përket afatit të implementimit të projektit dhe periudhës garantuese, i cili aneks është pjesë e kësaj dosje.

Për inxhinierin e ndërtimtarisë, te pika nën b) kuptohet se është kërkuar drejtimi konstruktiv, sepse më poshtë pika nën ç) kërkohej inxhinieri i hidros:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 15 (pesëmbëdhjetë) punëtorë si dhe staf të mjaftueshëm profesional për kryerjen e projektit si ne vijim a.) Një inxhinier i diplomuar-arkitekturës apo master inxhinier i arkitekturës me provojë 5 vjeçare pas diplomimit. b.) Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë apo master i ndërtimtarisë me provojë 5 vjeçare pas diplomimit. c.) Një inxhinier i diplomuar Elektroteknikës apo master i drejtimi-Elektroteknikës me provojë 5 vjeçare pas diplomimit. Ç.) Një inxhinier i diplomuar Hidroteknikës apo master i Hidroteknikës d.) Një inxhinier i diplomuar gjedezisë apo master i gjedezisë

Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës